



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____2023, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR FALJEN E BORXHEVE TË PA PAGUARA PËR TAKSËN PËR MARRJEN DHE MBAJTJEN E LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE AFARISTE

Neni 1

MIRATOHET, Vendimi për faljen e borxheve të pa paguara për taksën për marrjen dhe mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste për të gjithë taksapaguesit (subjektet afariste) të Komunës së Lipjanit për periodën kohore 01.01.2004 – 31.12.2013.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi do të shlyhen- fshihen nga evidenca e borxheve të pa paguara për taksën për marrjen dhe mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste të gjitha borxhet e taksapaguesve për periodën e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi të cilat figurojnë në pasqyrat financiare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

A r s y e t i m i

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Kuvendi i Komunës së Lipjanit me Rregulloren 15 Nr.313-13196 e datës 03.04.2014 për shfuqizimin e Rregullores për lejet për ushtrimin e vprimtarive afariste e Lipjanit ka shfuqizuar Rregulloren për lejet për ushtrimin e veprimtarive afariste 1nr.313-734 e datës 20.11.2008, në bazë të së cilës kanë qenë të përcaktuara taksat për marjen dhe mbajtjen e lejës së punës dhe që nga kjo periudë, subjektet e biznesit janë liruar nga obligimi për pagesën e këtyre taksave .

Meqenëse, ka kaluar një kohë e gjatë e këto borxhe janë të vjetërsuara mirëpo në pasqyrat tona financiare ende figurojnë si borxhe të mbetura, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi për faljen e borxheve siq theksohet në dispozitiv të këtij Propozim-Vendimi

1Nr. 432/03-55544
Lipjan, më 28.09 2023

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti

